

# RAPORTI

## I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional


“Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”

Universiteti EPOKA, Tiranë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Fisnik KADIU

Dr. Gjergji ISLAMI



Gusht, 2019

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Master Profesional në**  
**“Menaxhim Risku dhe mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti EPOKA
2	Fakulteti / Departamenti që e ofron	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit/ Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër i Ministrit të Arsimit të Sportit dhe Rinisë Nr. 698, date 19.10.2018
4	Titulli i programit të studimit:	“Master Profesional” në “Menaxhim risku dhe mbrojtje ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit”
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
7	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesëshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhë angleze
10	Programi ofrohet nga institucioni	PO
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
12	Diplomë e përbashkët /Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
13	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
14	Aktivizimi i programit të studimit për herë të parë	2018-2019
15	Numri i studentëve	20 studentë

Shënim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL





## HYRJE

### **Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”**

Programi i Studimit “Master profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” (më tej MR & MZIN) ofrohet nga Universiteti Epoka në Tiranë, dhe është licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Nr. 698, datë 19.10.2018 si program i ciklit të dytë, me kohë të plotë, 1 vit, dhe përbëhet nga 60 ECTS.

PS “MR & MZIN” i Universitetit “EPOKA” është ndërtuar mbi një program studimi të ciklit të parë dhe akreditohet për herë të parë. Të gjitha lëndët ofrohen në gjuhën angleze. Mësimi zhvillohet në pasditen e vonë ose në mbrëmje, ora 17.15 deri 21.00 dhe të shtunën paradite.

## **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

Prof. Asoc. Dr. Fisnik Kadiu

Dr. Gjergji Islami

Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, GVJ u asistua nga Kordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 29.07.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 39/12 Prot., “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Universiteti EPOKA është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Universiteti EPOKA përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 12/9 Prot., datë 12.11.2018 “Dërgohen komente në lidhje me draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit””.

Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ.

GVJ pasi u njoh me komentet e percjella nga institucioni, mendon se: Komentet e bëra për draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm nga Universiteti EPOKA, në përgjithësi janë lidhur me Rekomandimet e bëra në Raport. Rekomandimet në kuptimin e fjalës përbushin funksionalitetin e Standardeve të përcaktuara nga ana e Agjencisë për sigurimin e cilësisë në Arsimin e Lartë dhe njëkohësisht përmirësojnë cilësinë e kurrikulës për të cilën kërkohet Riakreditimi.

GVJ pasi u njoh me komentet e percjella nga institucioni, përgjigjet si më poshtë:

#### Rekomandimet e dhëna në RVJ:

- 1) Rekomandohet të riemërtohet programi në Master Profesional “Menaxhim Risku dhe Mbrojtja ndaj Zjarrit”. Ky riemërtim nuk lidhet me ndryshime përmbajtësore të programit por vetëm me përcaktimin më të qartë, të plotë dhe gjithëpërfshirës të fushave që programi mbulon dhe me përputhjen e titullit të këtij programi në anglisht: “PROFESSIONAL MASTER” IN “DISASTER RISK MANAGEMENT AND FIRE SAFETY”.
- 2) Duke pasur parasysh se në vitin akademik 2018-2019 të gjithë studentët kanë qenë të punësuar me kohë të plotë, rekomandohet që programi i studimit të zhvillohet me kohë të zgjatur (1.5 vite). Në këtë mënyrë



*garantohet që studentët të mos kenë mbingarkesë gjatë zhvillimit të programit dhe aktivitetet e parashikuara në planin mësimor të kryhen plotësisht.*

- 3) *Rekomandohet rishikimi i planit mësimor dhe rregullores së programit të studimit me qëllim rritjen e orëve totale që studenti duhet të konsumojë në auditor.*
- 4) *Rekomandohet ndarja e praktikës mësimore / profesionale nga puna për temën e diplomës si dy aktivitete që i përkasin kategorive të ndryshme sipas VKM 41/2018.*
- 5) *Rekomandohet organizimi i praktikës profesionale nga institucioni në bashkëpunim me partnerë publikë apo privatë. Programi i praktikës duhet të miratohet nga departamenti dhe duhet të monitorohet nga personeli akademik. Gjithashtu puna praktike duhet të dokumentohet në trajtë relacioni ose ditari dhe të miratohet nga institucioni / kompania që e ofron praktikën.*

**Në shkresën Nr. 12/9 Prot, Dt. 02.08.2019, Institucioni paraqet mendimet e tij si më poshtë:**

- Nuk paraqiten komente mbi përmbajtjen e Draft RVJ
- Shprehet dakordësia në parim me përfundimet e pikës 11 të Draft RVJ
- Shpreh mosdakordësinë me Rekomandimin 1 duke paraqitur argumentimin përkatës
- Shpreh dakordësinë me Rekomandimet 4, 5
- Nuk shprehet për rekomandimin 2, 3

Në vijim të sa më sipër GVJ mori parasysh komentet mbi Rekomandimin 1 dhe bëri riformulimin si më poshtë.

*Rekomandohet rishikimi i përmbajtjes dhe/ose emërimit të programit të studimit që të reflektohet përputhshmëri e plotë mes aktiviteteve formuese të ofruara dhe profilit të specialistit të formuar përmes këtyre aktiviteteve. Aktualisht programi jep njohuri formuese mbi fusha që lidhen me inxhinierinë e ndërtimit, arkitekturën, peizazhin, planifikimin / territorin, topografinë, gjeologjinë, hidrologjinë, mjedisin etj. GVJ sugjeron shkurtimin e emërimit të programit në Master Profesional “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit”, ose rishikimin e përmbajtjes së kurrikulës për t’u fokusuar vetëm në fushat që janë pjesë e inxhinierisë së ndërtimit.*





## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.*

Qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në “MR & MZIN” është që të përgatisë specialistë të kualifikuar, të cilët përmes përvetësimit të njohurive të thella në këtë fushë të jenë në gjendje për të kontribuar për një shoqëri të sigurt, duke zvogëluar rreziqet dhe përmirësuar sigurinë. Programi i studimit synon gjithashtu të menaxhojë më mirë risqet prej fatkeqësive natyrore që shkaktojnë përmbytjet e lumenjve, zjarret etj. thellime me njohuri edhe për çështje kritike të strukturave të sigurisë ndaj zjarrit dhe sjelljen e tyre në aftësinë mbajtëse, duke aplikuar metoda të avancuara të modelimit. Mendojmë se njohuritë e fituara janë në përputhje edhe me kërkesat që shtron sot koha në fushën e menaxhimit të risqeve në emergjencat dhe mbrojtjen ndaj zjarrit në veprat e inxhinierisë së ndërtimit.

Objektivat e programit të Studimit “Master Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” lidhen me:

- zgjerimin njohurive specifike për një shoqëri më të sigurt dhe zvogëlimin e rreziqeve dhe përmirësimi i sigurisë ndaj zjarrit dhe fatkeqësitë natyrore e njerëzore,
- aftësimin e studentëve për të identifikuar dhe zgjidhur problematika komplekse për zvogëlimin e ndikimeve negative të katastrofave dhe zjarrit në jetën e përditshme;
- rritjen e ndërgjegjësimit e studentëve rreth kostos, kohës dhe çështjeve të cilësisë në veprat e inxhinierisë së ndërtimit; duke rritur aftësitë e tyre për të mbledhur, analizuar dhe interpretuar të dhëna;
- zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave për të menaxhuar rreziqet nga fatkeqësitë dhe sigurisë ndaj zjarrit, duke u ofruar studentëve njohuri për çështjet bashkëkohore në fushën e MR & MZIN dhe mjetet e qasjet inxhinierike të mbrojtjes së jetës së njerëzve. [RVB fq. 16]

Programi i Studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është në përputhje me qëllimin dhe misionin e Universitetit Epoka, përcaktuar në statutin e UEpoka [RVB, Shtojca 23].

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit MP “ Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është në përputhje me qëllimin dhe misionin e U Epoka [Shtojca 23, Statuti U Epoka]. Programi i Studimit MP në “MR & MZIN” është hartuar duke patur parasysh nevojat e tregut për specialistë brenda fushës së programit.  Lidhur me emërtimin e Programit të studimit “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” sugjerojmë që prapashtesa “... në Inxhinierinë e Ndërtimit” të mos jetë, pasi mendojmë se e kufizon fushën e aktivitetit të Menaxhimit të Riskut dhe Mbrojtjen ndaj Zjarrit vetëm në atë të Inxhinierisë së Ndërtimit, ndërkohë që realisht fenomenet e riskut dhe mbrojtjes ndaj zjarrit janë edhe shumë më tepër se kaq, si në industrinë mekanike, kimike e metalurgjike, bujqësi,
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	



	<p>magazinim të produkteve me rrezik zjarri, objekte administrative, kulturore etj.etj.</p> <p>Ky ndryshim do sillte edhe përafrim me emërtimin e Projektit K-Force “Disaster Risk Management and Fire Engineering” në të cilin ky program zhvillohet në bashkëpunim edhe me Universitetet në: Novi Sad - Serbi, Bosnje Hercegovina, Mali i Zi dhe në Shqipëri në “Universitetin Epoka”. [Takimi i GVJ me Drejtuesit e Programit të studimit, stafin akademik dhe studentët].</p> <p>Drejtuesit e programit kanë hartuar dhe zhvilluar dhe anketime gjatë vitit 2017 me qëllim që analiza e tregut të shërbejë si bazë për zhvillimin e programit të studimit MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” [Shtojca 2, Studimi i tregut për hapjen e programit të studimit MP në MR &amp; MZIN]</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programet e studimit që ofron UEpoka janë në përputhje me qëllimin, misionin dhe strategjitë e zhvillimit të Institucionit. Plani mësuesorë i programit të studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është hartuar në përputhje me misionin e UEpoka, në kontekst lokal dhe ndërkombëtar [Shtojca 21 “Strategjia dhe Plani i Veprimit i Universitetit “EPOKA” 2018-2022]
<b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i Studimit është në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e nxjerra në fuqi.</p> <p>Studenti që diplomohet në këtë program studimi i ka mundësitë të punësohet në tregun vendas në sajë të zgjerimit dhe përmirësimit të njohurive dhe aftësive të tyre në këtë fushë. [Shtojca RVB, faqe 15],</p> <p>[Shtojca 49: Plani strategjik i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit 2017 - 2022], i bërë publik në link-un <a href="http://epoka.edu.al/mat/2018%2012%2019_Framework%20Strategy%20and%20Action%20Plan%202018-2022.pdf">http://epoka.edu.al/mat/2018%2012%2019_Framework%20Strategy%20and%20Action%20Plan%202018-2022.pdf</a></p>
<b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>UEpoka ka hartuar një plan strategjik në nivel Institucional për periudhën kohore 2018-2022.</p> <p>[Shtojca 21, Strategjia dhe Plani i Veprimit i Universitetit “EPOKA” 2018-2022],</p> <p>[Takimi me drejtuesit e programit të studimit, dekani dhe drejtuesi i departamentit],</p> <p>[Shtojca 49: Plani strategjik i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit 2017-2022],</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i Studimit në MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është në përputhje me qëllimet, misionin dhe strategjinë e zhvillimit të UEpoka.</li> <li>- Objektivat e programit të studimit përcaktojnë në mënyrë të qartë aftësitë, dijet dhe kompetencat teknike</li> </ul>	



që duhet të fitojnë studentët me përfundimin e programit të studimit.

- Programi i studimit në MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është hartuar duke patur parasysh nevojat e tregut për specialistë të cilët janë të mangët në këtë fushë dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të U Epoka.
- Programi i studimit në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” ofrohet në përputhje të plotë me aktet ligjore të Sistemit të Bolonjës dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Rekomandim:

- Rekomandohet rishikimi i përmbajtjes dhe/ose emërimit të programit të studimit që të reflektohet përputhshmëri e plotë mes aktiviteteve formuese të ofruara dhe profilit të specialistit të formuar përmes këtyre aktiviteteve. Aktualisht programi jep njohuri formuese mbi fusha që lidhen me inxhinierinë e ndërtimit, arkitekturën, peizazhin, planifikimin / territorin, topografinë, gjeologjinë, hidrologjinë, mjedisin etj. GVJ sugjeron shkurtimin e emërimit të programit në Master Profesional “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit”, ose rishikimin e përmbajtjes së kurrikulës për t’u fokusuar vetëm në fushat që janë pjesë e inxhinierisë së ndërtimit.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit /departamentit përgjegjës për programin e studimit

### Pjesa përshkrimore


*Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit*

Nga takimi me drejtuesit e Fakultetit dhe të Departamentit, konfirmohet se Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë është njëra nga njësitë kryesore akademike në Universitetin “EPOKA”, i cila koordinon zhvillimet mësimore dhe kulturore në fushat e mësimdhënies dhe kërkimit. Universiteti “EPOKA” përbëhet nga tre fakultete (Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale) dhe secili prej tyre përbëhet nga të paktën 3 (tre) departamente apo qendra të kërkimit shkencor. Titullarët akademik janë: Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. Organi drejtues akademik është Dekanati. Autoriteti drejtues administrativ është Administratori i njësisë kryesore. Universiteti Epoka dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si pjesë përbërëse e tij është krijuar në vitin akademik 2007-2008. Dekanati i Fakultetit është një organ vendimmarrës kolegjal, i cili përcakton dhe programon sipas propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të Fakultetit. Dekanati i Universitetit “EPOKA” është një organ ekzekutiv kolegjal i njësive kryesore përkatëse dhe përbëhet nga: Dekani; Zv/Dekani; Administratori i njësisë kryesore dhe Përgjegjësit e Departamenteve/qendrave kërkimore. Programi i studimit “Master Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” menaxhohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, kjo edhe në zbatim të ligjit 80/15. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ofron programe për të tre ciklet në Inxhinierinë e Ndërtimit. Programet e ciklit të parë, bazohen në sistemin trevjeçar dhe studentët diplomohen në Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë përfshijnë studimet “Master i Shkencave”, “Master Profesional” dhe studimet në “Doktoraturë” (PhD) në Inxhinieri Ndërtimi.

Departamenti përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Personeli i huaj dhe ai shqiptar është tërësisht i përkushtuar për funksionimin sa më të mirë të departamentit. Stafit është i kualifikuar në institucione të rëndësishme si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit (Tabelat 1 dhe 2, Aneks)





Tabelat 1 dhe 2 japin të dhëna për stafin akademik dhe administrativ (PAE, PAK dhe PA) të njësive bazë të Fakultetit dhe departamenteve që e përbëjnë atë. Në këto tabela reflektohet numri i stafit akademik, konkretisht si më poshtë:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit: 7 PAE/ 3 PAK/2 PA
- Departamenti i Arkitekturës: 8 PAE/ 6 PAK/ 1 PA
- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike 13 PAE/ 13 PAK/1 PA

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Universiteti "EPOKA" është i organizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim që të përmbushë misionin e vet.</p> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit është i organizuar sipas një strukture që ndihmon në përmbushjen e misionit të tij dhe përbëhet nga 3 (tre) departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Arkitekturës;</li> <li>- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe</li> <li>- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike</li> </ul> <p>[RVB, faqe 20, Organigrama e Fakultetit].</p> <p>Departamentet, funksionojnë e veprojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit <b>është përgjegjës për programin e studimit</b> dhe përbëhet nga një personel akademik prej 7 (shtatë) pedagogësh me kohë të plotë (PAE), prej të cilëve 2 Prof. As, 4 Dr/PhD dhe 1 Msc (PhD në proces); si dhe 3 pedagogë me kontratë (PAK) prej të cilëve 1 Prof. As, 2 Msc</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit është me titull Prof. As. [Takimi me stafin akademik dhe, tabela 2, në aneks].</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamentet janë të angazhuar drejtpërsëdrejti në realizimin e programeve të studimeve. Departamenti i inxhinierisë së ndërtimit siguron zbatimin e programit të studimit edhe në bashkëpunim me dy departamentet e tjera. Departamenti i Inxhinierisë e ka hartuar programin e studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Fakulteti dhe departamenti janë të përfshira në procesin e rekrutimit të stafit akademik [Shtojca 11, Rregullore "Për Rekrutimin e personelit"].</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UEpoka ka strukturën e nevojshme për të përmbushur misionin e tij.</li> <li>- UEpoka është i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe të gjitha njësitë</li> </ul>	



përkatëse janë të përfshira në funksionimin normal të programit të studimit.

- Rekrutimi i stafit është transparent dhe funksional. Gjithashtu, departamentet janë të përfshirë në procesin e rekrutimit të personelit akademik.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkimore

*Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.*

Për realizimin e programit të Studimit MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, është angazhuar personel akademik, i cili përbëhet vetëm nga pedagogë me kontratë me kohë të plotë (PAE) si dhe staf mësimor ndihmës.

Universiteti Epoka zbaton procedura transparente për rekrutimin e personelit akademik [Shtojca Shembull Kontrate e Stafit Akademik].

Në programin e studimit MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, janë angazhuar në mësimdhënie 9 (nëntë) anëtarë staf akademik, prej të cilëve 3 (tre) me tituj Prof. As. Dr., 6 (gjashtë) me gradën Dr/PhD.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela 3, Aneks)

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë të angazhuar në programin e studimit MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, është si vijon:

Viti Akademik: 2018-2019, raporti PAE/PAK është 9/0 ose (100 %/0 %),

Viti akademik: 2018-2019, raporti PAE/Personel administrativ është 9/5,

Viti akademik: 2018-2019, raporti PAE/Student është 9/20,

Viti akademik: 2018-2019, raporti Personel administrativ/Student është 5/20

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit [Tabela Nr. 4, Aneks]

Në Departamentin e Inxhinierisë së ndërtimit të U Epoka është funksional dhe Komiteti Shkencor, i cili vlerëson kandidaturat për vendet e lira për mësimdhënie, zhvillon intervista, vendos për leksione të hapura të kandidateve dhe vlerëson performancën e tyre. Komiteti shkencor vendos edhe për kompetencën akademike të kandidateve. [Shtojca 11, “për rekrutimin e Personelit, RVB].

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Personeli akademik në programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, ka në përbërje të tij:

- nga Departamenti i Inxhinierisë së ndërtimit (departamenti përgjegjës): 6 (gjashtë) Personel Akademik Efektiv (PAE) prej të cilëve 2 (dy) Prof.As.Dr, 1 (një) PhD, 3 (tre) Dr,



- nga Departamenti i Arkitekturës: 3 (tre) Personel Akademik PAE 1 (një) Prof. As. Dr dhe 2 (dy) Dr.

Të dhënat sipas moshës së personelit (*Tabelat Nr. 3.2 Anekse*)

Nga tabela 9 në aneks, u konstatua që shpërndarja e moshës së stafit të angazhuar në programin e studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, drejtuesit e lëndëve i përkasin grup moshës 36-65 vjeç, ndërsa stafi akademik 25-65 vjeç përfshirë dhe personelin ndihmës-akademik e administrativ.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontratat e punës që nënshkruhen mes Universitetin “EPOKA” (Rektorit) dhe personelit akademik me kohë të plotë janë njëvjeçare ose pa afat, ndërsa për personelin akademik me kohë të pjesshme janë semestrale. Në muajin Mars 2019 U Epoka ka miratuar rregulloren e re të punësimit. Kandidatët, e rekrutuar përzgjidhen nga Komiteti Shkencorë apo komisioni i ngritur për këtë qëllim, pasi kanë prezantuar përpara stafit e studentëve një leksion të hapur që lidhet me fushën e tyre të mësimdhënies. Këto kontrata përmbajnë të drejtat dhe detyrat e palëve sipas statutit dhe rregullores së universitetit.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës administrativ në njësinë e këtij programi studimi është me eksperiencën e duhur për pozicionet dhe detyrat që zgjidh.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Stafi akademik dhe ai administrativ i programit të studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit është i angazhuar në përputhje me objektivat e programit dhe realizimin e tij në bashkëpunim edhe me pedagogë të departamenteve të tjera të fakultetit.</p> <p>Stafi akademik dhe administrative i programit të studimit MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” angazhohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. [<i>Shtojca 21, Plani Strategjik i UEpoka dhe zhvillimit të programit</i>].</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi akademik është i angazhuar në rishikimin e kurrikulave dhe në vendimet institucionale. Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave është detyrë parësore e stafit mësimdhënës [<i>Takimi me Dekanin dhe stafin akademik, 17.06.2019</i>]. Gjithashtu, rishikimi i kurrikulave merr parasysh edhe mendimet nga Kompanitë ku punësohen dhe kryejnë praktikat studentët [<i>Shtojca 2, Studimi i tregut për hapjen e programit MP në “MR &amp; MKZIN”</i>].</p> <p>Rekrutimi i stafit akademik dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore është transparent dhe në përputhje me ligjet në fuqi. [<i>Shtojca 11, Rregullore “Për Rekrutimin e personelit”</i>]</p>
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e</b>	



<b>personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Universiteti Epoka, zbaton procedura ligjore transparente për rekrutimin e personelit akademik. Në zyrën e Burimeve Njerëzore [Takimi i datës 18.06.2019] gjenden të dhëna të detajuara për secilin anëtar të personelit akademik, ndihmës dhe administrativ. Informacioni dhe të dhënat janë të plota për të gjithë personelin akademik respektivisht me lëndët dhe semestrat në të cilat është i angazhuar stafi i programit të studimit.</p> <p>Të gjitha lëndët e parashikuara në programin e studimit lëndë realizohen nga stafi akademik efektiv. [Tabela 3.1, në Aneks]. Nga kjo tabelë, që tregon situatën përpara vizitës, GVJ gjatë vizitës evidenton të njëjtën situatë. Referuar RVB (tabela 7) dhe Tabelave 2 ne Aneks, tre pedagogë janë të departamenteve të tjera, por brenda Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë.</p> <p>Referuar Tabelës 9, në Aneks, evidentohet se të gjitha lëndët (13 lëndë) zhvillohen dhe mbulohen nga personel akademik PAE, [RVB, Tabela 26 “Kurrikula e programit të studimit “MR &amp; MZIN” e RVB, faqe 86].</p> <p>Gjithashtu, nga takimi me stafin akademik si edhe nga tabela 9 “Plani mësimorë i lidhur me personelin akademik”, reflekton për disa pedagogë një mbingarkesë deri në 9 (nëntë) lëndë dhe ngarkesë mësimore javore deri 18 orë/javë, duke tejkaluar kufijtë limit të rekomanduara në Udhëzimin Nr. 29 të Ministrisë të Arsimit, për të gjithë pedagogët përfshi edhe ato me tituj e grada shkencore. [Takimi me stafin akademik, data 17.06.2019].</p> <p>Për vlerësimin e stafit akademik, Universiteti Epoka zbaton procedura transparente. Vlerësimi kryhet nga studentët por edhe nga vetë drejtuesi i departamentit [Shtojca 22: Direktiva “Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë”, shtojca 46 Modeli, Forma e Vlerësimit të Mësim-dhënësve]. Nga muaji Mars 2019, UEpoka zbaton Direktivën [EU-DIR-021-EN, data 063.03.2019] për Vlerësimin e Performancës dhe Përmirësimin i cilësisë. Për vendet vakante institucioni zbaton procedura shumë transparente.</p>
<b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit,</p>	<p>Programi i studimit udhëhiqet nga Drejtuesja e Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit, me titullin akademik Prof. As.Dr (Tabela 2, në Aneks).</p> <p>NA</p> <p>Për të gjitha lëndët konstatuam se ato mbulohen nga personel akademik minimalisht me gradë shkencore “Doktor”, me përvojë në mësimdhënie mbi 5vjet [Shtojca 47, CV e personelit akademik të programit të studimit].</p> <p>Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit dhe njëkohësisht edhe përgjegjësi i programit të studimit janë personel akademik të punësuar me kohë të plotë në Universitetin “EPOKA”.</p>



<p>përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Departamenti nga ana e tij, siguron mbështetje me personel të mjaftueshëm për udhëheqjen e diplomave dhe mbështetjen me personel mësimor- kërkues për realizimin e seancave laboratorike etj. Mbikëqyrja e praktikave profesionale i besohet kryesisht specialistëve në vendet e punës ku studenti kryen praktikën profesionale dhe jo pedagogëve të U Epoka. [Takimi me stafin akademik 17.06.2019 dhe studentët 18.06.2019] Raporti student/ personel akademik është 20/9 [RVB dhe Takimi me studente e stafi akademik]</p>
--	--

**Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.**

<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentëve u caktohet një udhëheqës për të përgatitur tezën e diplomës në master profesional. Udhëheqësit e diplomave kanë të gjithë gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Njëri nga Udhëheqësit, ka në mbikëqyrje 7 (shtatë) studentë. Sugjerojmë që për numrin e studentëve që ndjekin studimet në programin MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, janë të gjitha mundësitë që numri i studentëve që udhëhiqen nga një udhëheqës të jetë më i vogël se 5 (pesë).</p> <p>Studentët mund të zgjedhin udhëheqësin e tezave në përputhje me interesat e tyre duke paraqitur kërkesën për propozimin e tyre lidhur me tematikën e tezës, propozim i cili miratohet nga udhëheqësi dhe përgjegjësi i Departamentit</p>
---	--

**Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.**

<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit e diplomave kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” në shkencat inxhinierike dhe janë në përputhje me fushën e studimit. Ata zotërojnë nivele teorike të avancuara dhe kanë botime shkencore, [Shtojca 47, CV e personelit akademik të programit të studimit].</p>
---	--

**Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Universiteti Epoka, ofron shërbime për realizimin e orëve mësimore, siç janë laboratorët e kompjuterave që mirë-mbahen nga personeli administrativ nën përgjegjësinë e Zyrës ICTC, ndërsa Laboratori i Materialeve e Strukturave të Inxhinierisë së Ndërtimit mirëmbahet nga përgjegjësi i laboratorit, personeli teknik dhe akademik.</p> <p>Secili leksion dhe seminar ka klasën e vet sipas nevojave të kursit. Në mësim, pedagogët mbështeten nga personel ndihmës mësimor ose/dhe shkencor. Për të mbuluar tematika specifike, Universiteti “EPOKA” në kuadër të këtij programi studimi fton specialistë vendas dhe të huaj të kualifikuar për të zhvilluar “leksione të hapura” sipas programit në Syllabuset e lëndëve.</p>
---	---



**Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

**Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit ofron programe studimi Bsc, Msc dhe MP.

Llogaritja e ngarkesës mësimore për stafin akademik bazohet në “Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik” Ngarkesa mësimore llogaritet në bazë të numrit të orëve leksione, seminare dhe laboratorë, siç përcaktohet në nenin 2 të Direktivës "Për ngarkesën mësimore". [Shtojca 10, Direktiva "Mbi ngarkesën e mësimdhënies"], [Takimi me drejtuesit dhe stafin akademik], [Direktiva EU-DIR-021-EN, data 06.03.2019 për “Vlerësimi i Performancës dhe Përmirësimi i cilësisë të Stafit akademik dhe administrativ”].

**Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

**Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

**Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Në zyrën e Burimeve Njerëzore gjenden të arkivuara të dhëna të hollësishme për personelin akademik, ndihmës dhe administrativ. Ka një listë të plotë të personelit akademik me lëndët përkatëse të ndara sipas semestrave.

Universiteti Epoka zbaton procedura transparente dhe të qarta për rekrutimin dhe punësimin e personelit akademik si në nivel departamenti ashtu dhe në nivel Institucional dhe ndiqen edhe nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Vendet e lira, kriteret dhe procedurat për aplikim publikohen rregullisht në faqen e internetit të Universitetit Epoka, seksioni i ZBNJ, [<http://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html>]

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Stafi akademik dhe administrativ i programit të studimit MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, është në përputhje me objektivat e programit dhe në realizimin e tij.
- Grupi i ekspertëve vlerëson përmbushjen e kriterëve në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi. Departamenti zbaton procedura transparente për vlerësimin e performancës në mësimdhënie. Vlerësimi kryhet nga studentët e programeve si dhe nga drejtuesi i Departamentit. Zyra e Burimeve njerëzore mban të gjitha të dhënat e personelit.
- Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar, me aktivitet të pasur akademik. Raportet PAE/PAK janë në vlerat 100%/0.0%.
- Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2018-2019 tregon se pedagogët kanë mbingarkesë të lartë në mësimdhënie.

**Rekomandim:**

- Grupi i ekspertëve sa i takon mbikëqyrjes së studentëve gjatë kryerjes së praktikave profesionale rekomandon që Departamenti si drejtues i këtij programi studimi duhet të realizojë mbikëqyrjen e studentëve në praktikat profesionale edhe nga stafi akademik në mënyrë të programuar dhe me përgjegjësi institucionale.



#### 4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat*

Universiteti "EPOKA" ndodhet në rrugën Tiranë-Rinas, në kilometrin 12. Kampusi (rezidencat) shtrihet në një sipërfaqe totale 67 000 m<sup>2</sup>. Universiteti Epoka, ofron një infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e të gjithë aktiviteteve të nevojshme siç janë mjediset e brendshme e të jashtme të një niveli dhe cilësie shumë të lartë dhe kushte jo vetëm për mësim por edhe për punë të pavarur të studentëve. Ambientet e vizituara nga GVJ, si klasa, auditorë, laboratorë kompjuterik, laboratorë të testimeve të materialeve e strukturave të ndërtimit me sipërfaqe 280 m<sup>2</sup>, salla studimi, zyrat te stafit akademik e administrativ, biblioteka si dhe hapësirat e tjera të përbashkëta si mensa etj. Programi MP në "Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit" realizohet në godinën e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Mjediset janë të pajisura me sistem ngrohje-ftohje dhe me video-projektorë.

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit jepen **në Tabelat 6** në aneks

##### Mjediset e Fakultetit

- Salla për leksione, 5 salla me sip 752m<sup>2</sup>,
- Klasa për seminare, 18 me sipërfaqe 1604m<sup>2</sup>
- Salla për aktivitete promovuese, 1 me sipërfaqe 128m<sup>2</sup>,
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale, 2 me sipërfaqe 258m<sup>2</sup>
- Laboratorë për lëndët, 4 me sipërfaqe 233m<sup>2</sup>
- Laboratorë informatike, 3 me sipërfaqe 174.6 m<sup>2</sup>
- Salla interneti, 2 me sipërfaqe 151.8 m<sup>2</sup>
- Salla për bibliotekë, 1 me sipërfaqe 322 m<sup>2</sup>
- Mjedis për fotokopjime, librari etj, 1 me sipërfaqe 33.6 m<sup>2</sup>
- Zyrë informacioni për studentët, 2 me sipërfaqe 71 m<sup>2</sup>
- Nyje hidrosanitare, 54 me sipërfaqe 327.2

##### Mjediset për stafin:

- Mjedisë për Dekanin/ kancelarin, 5 me sipërfaqe 285.5 m<sup>2</sup>
- Zyra për sekretarinë mësimore, 3 me sipërfaqe 78.5 m<sup>2</sup>
- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore, 12 me sipërfaqe 328.5 m<sup>2</sup>
- Zyra për personelin akademik, 40 me sipërfaqe 620 m<sup>2</sup>
- Nyje hidrosanitare, 35 me sipërfaqe 212 m<sup>2</sup>

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, e konsideron dokumentacion e paraqitur në RVB sa i takon infrastrukturës në Universitetin Epoka të plotë.

##### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti "EPOKA" ka vendndodhje të përhershme dhe përbëhet nga mjedisi qendror administrativ dhe veprimtaria mësimore dhe ajo ndihmëse, përfshirë bibliotekën, zyrat e stafit akademik, laboratorë kompjuterikë, laboratorit i provave të materialeve e strukturave të ndërtimit etj.</p> <p>Universiteti "EPOKA" ka në pronësi ambientet që përdoren për aktivitetet e Universitetit.</p> <p>Universiteti "EPOKA" siguron menaxhim efikas dhe garanton kapacitete për standardet dhe zbatimin e politikave për programin e studimit "Master Profesional" në "Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit".</p>
---	---

### Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka ofron një fond të konsideruar librash dhe literature në funksion të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Literatura, përbëhet nga tekste, mësimore dhe literaturë ndihmëse me mbi 2,000 revista akademike/shkencore për realizimin e programit të studimit të MP në MR &amp; MZIN; ajo është në gjuhë të ndryshme sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe personelit akademik.</p> <p>Biblioteka e Universitetit Epoka, pasurohet çdo vit me tituj të rinj. Universiteti "EPOKA" ka akses edhe në disa biblioteka online ku studentët mund të lexojnë dhe të shkarkojnë shumë libra dhe punime shkencore [<a href="http://www/.jstor.org/">http://www/.jstor.org/.</a>]</p> <p>Biblioteka funksionon nga dita E Hënë- E Premte: Ora 08:30 - 12:30 dhe Ora 13:30 - 17:30 dhe E Shtunë, ora 09:00 - 13:00 dmth, oraret janë në përshtatje edhe me oraret e programit të studimit MP ë "MR&amp;MZIN" dhe nevojat e studentëve.</p>
--	--

### Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Universiteti Epoka ka infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimorë. [ <i>RVB, Tabela 12</i> ] dhe dëshmon se ka ambiente të mjaftueshme për të realizuar programin e studimit.</p> <p>Laboratorët mësimore janë të pajisur me pajisjet e përshtatshme dhe mjetet e nevojshme në përputhje me qëllimet e programit. Zyra e IT është përgjegjëse për asistencë teknike në laboratorët [ <i>RVB, Tabela 14, fq. 44</i> ]</p> <p>Klasat janë të pajisura me kompjuter, video-projektor, dhe tabela interaktive. Në dispozicion të programit të studimit veç tre laboratorëve të pajisur me kompjuterë për zhvillimin e praktikave mësimore, është shtuar dhe një laborator i ri me 42 kompjuterë të fituar në kuadër të programit K-Force të këtij programi studimi [ <i>Vizita e GVJ në ambientet e UEpoka, 18.06.2019</i> ]. Në të gjitha ambientet e Universitetit Epoka ka akses Interneti.</p>
--	--

### Konkluzionet e vlerësimit:

- Infrastruktura dhe mjediset e Universitetit Epoka plotësojnë kërkesat për zhvillimin normal të procesit mësimor për programin e studimit MP "Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e



Ndërtimit”.

- Laboratorët janë të pajisur me kompjuterë dhe softuerë të nevojshëm për zhvillimin e gjithë procesit mësimor. Sallat dhe auditorët i plotësojnë standardet dhe kriteret e cilësisë.
- Biblioteka ka një numër të konsiderueshëm të librave, të revistave dhe publikimeve të tjera shkencore në shërbim dhe në përshtatje me programin e studimeve. Orari i përshtatet me orarin e programeve të studimit. Universiteti “EPOKA” operon në mjedise të mjaftueshme si: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të kohës.
- Në laboratorët e kompjuterave dhe në ambientet e tjera të Universitetit Epoka Studentët e programit të studimit kanë akses të plotë në Internet.

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.*

Sipas RVB [fq. 64], dhe vizita në sektorin e Financës, vërejmë se Zyra e Financës në Universitetin Epoka është e ngarkuar për zbatimin e politikave financiare institucionale. Universiteti Epoka, për aktivitetin financiar, kryen auditime çdo vit nga një kompani auditimi e jashtme, me aktivitetin e saj në Shqipëri. [RVB, fq. 67]. Raportet e këtyre auditimeve janë të disponueshme në zyrën e Financës të Universitetit Epoka. Tabela 5 në Aneks, kanë të detajuara respektivisht të ardhurat për Universitetin "EPOKA" gjatë vitit akademik 2017-2018.

Ndërsa, për programin e studimit në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” për vitin 2018-2019 janë planifikuar shpenzime respektivisht për Paga (34.8%), për Shpenzime (45.5%) dhe për investime (19.7%).

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Për programin e studimit “Master Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” nuk është aplikuar asnjë tarifë shkollore për studentët. Të gjitha shpenzimet e studentëve, mobilitetet për tre studentë, mobilitetet për stafin, botimi i dy librave etj., janë të mbuluara nga projekti K-Force.

Në Aneks është paraqitur Tabela 5, për të ardhurat në vitin akademik 2017-2018, ku dallohet që 92.4 % janë të ardhurat nga Tarifatat e shkollimit, 7.2 % nga Grantet për kërkim dhe kontratat dhe 0.4 % nga aktivitetet tregtare etj

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje).

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student konsulentat, sponsorizimet, shërbimet për trajnime, donacione, aktivitete siguroese etj. për vitin akademik 2018-2019 nuk janë përcaktuar pasi, programi i studimit në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” nuk ka përfunduar. Për programin e studimit “Master Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, viti akademik 2018-2019 nuk janë aplikuar tarifa shkollore për studentët. Shpenzimet janë të mbuluara nga projekti K-Force, me përjashtim të shpenzimeve të pedagogëve të aktivizuar në këtë program studimi.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	



<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p>Universiteti Epoka është subjekt i një auditimit vjetor të jashtëm për situatën financiare të tij Gjatë vizitës vlerësuese konstatoam që një raport i detajuar gjendet në zyrën e Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a. Sipas përgjegjësisë të Zyrës së Financës në Universitetin Epoka na u tha se Raporti përmban të gjitha analizat e të dhënave mbi të ardhura- shpenzimet e shoqërisë dhe institucioneve të përfshira, të gjitha të dhënat kontabël lidhur me të ardhurat (grantet, tarifat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron direkt ose indirekt.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfuturave dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	

**Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishe financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p>	<p>Universiteti Epoka, me përfundimin e vitit akademik harton raportin vjetor që pasqyron koston dhe efektivitetin e çdo programi studimi duke analizuar dhe shpenzimet e kryera. [RVB, Standardi VI.1, Kriteri 1].</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në raportin financiar zyrtar të Turgut Ozal Education sh. a., shoqëria ka bilanc vjetor pozitiv që garanton qëndrueshmëri e kapacitete financiare në perspektivë të institucionit. [RVB, Tabela 16, Të ardhurat dhe financimet e ndryshme të Universitetit "EPOKA" gjatë vitit akademik 2017-2018].</p>

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Bazuar në dokumentet të vënë në dispozicion dhe RVB, Universiteti Epoka vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare, harton raport financiar të kostove për çdo program studimi.
- Universiteti Epoka dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe garanton zhvillimin edhe të programit të studimit në MP "Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit". Për vitin akademik 2018-2019 të gjitha shpenzimet për studentët përballohen në kuadër të projektit K-Force.
- GVJ, bazuar në pasqyrat financiare të mundësuar në RVB dhe të dhënat gjatë vizitës në UEpoka dëshmojnë për qëndrueshmëri financiare të institucionit, që mundëson dhe programin në vijim të MP "MR&MZIN".

**6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

**Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.*

Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë (NJSBC) në Universitetin Epoka, është institucionalizuar si një strukturë organizative e përhershme emërtuar "Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë" (KPSC) nën Senatit Akademik, i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të ofruar nga Universiteti "EPOKA" në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë (NJSBC), Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Bordin e Provimeve [RVB, fq. 70], [Shtojca 21 "Plani Strategjik i UEpoka, 2018-2022]. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit, është zgjedhur nga Senati Akademik [ Shtojca "Statuti i U Epoka, neni 35 ].

Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët janë përfaqësues të secilës njësi kryesore, duke përfshirë edhe kryetarin.



Të gjitha propozimet për të bërë ndryshime në kurrikulën ekzistuese paraqiten sipas Formularit të Propozimit të Ndryshimit të Kurrikulës [RVB, Shtojca 39] dhe në Politikën "Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit". [RVB Shtojca 40].

Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës shqyrton të gjitha propozimet për lëndë të reja dhe ndryshime në lëndët ekzistuese të kurrikulës të programit të studimit dhe siguron mbështetje dhe këshilla për departamentet përkatëse për zhvillimin e kurrikulave.

Bordi i provimit përbëhet nga një kryetar dhe të paktën një përfaqësues nga secili fakultet. Bordi i provimeve siguron cilësinë e provimeve në përputhje me Direktivën "Për funksionimin e Bordit të provimit". [RVB, Shtojca 41] dhe Udhëzimit "Për provimet". [RVB, Shtojca 42]. Bordi i Provimeve vlerëson cilësinë e provimit në bazë të raporteve që kërkohen nga fakultetet përkatëse. [RVB, Shtojca 43 dhe 44].

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit.

Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Komisioni i i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë) janë paraqitur në Tabelën 7 në Aneks. Në programin e studimit MP në "MR & MZIN", në fund të semestrit të parë; studentët e UEpoka kanë plotësuar në sistemin elektronik *anketime konfidenciale* për vlerësimin e pedagogut të secilës lënde, duke treguar edhe renditjen e pedagogëve në nivel Departamenti dhe Fakulteti. [ Shtojca 45, RVB], [Formulari i anketimit gjendet në linkun e [https://drive.google.com/open?id=0Bwl\\_QkbaNe5IeHFqRDVhZfVjNkk](https://drive.google.com/open?id=0Bwl_QkbaNe5IeHFqRDVhZfVjNkk)].

KPSC-ja me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, kryen analiza sasiore dhe cilësore të rezultateve të studentëve dhe del me rekomandimet përkatëse, duke evidentuar problematikat dhe fushat ku nevojitet përmirësim i mëtejshëm. Zyra e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, realizon seminare trajnimi dhe informimi periodike për personelin e institucionit, në lidhje me dhe rëndësinë që ka sigurimi e cilësisë në përgjithësi dhe sistemet e menaxhimit të cilësisë në veçanti. KPSC-ja, me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, është i angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor brenda Universitetit "EPOKA".

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Me mbarimin e vitit akademik, kryhet vlerësimi i stafit akademik nëpërmjet nga vlerësimet e studentëve në bazë të çdo kursi, vlerësimin e performancës individuale nga fakulteti si dhe vlerësimin në raportet vjetore mbi mësimdhënien, të nxënit dhe standardet e lidhura me cilësinë nga departamenti në fund të çdo viti akademik [ Shtojca 46 Modeli, Forma e Vlerësimit të Mësimdhënësve, FAE], [Shtojca 45 Rezultatet e anketimit të vlerësimit të lëndëve të pedagogëve MP në MR & MZIN], [Shtojca 4: Anketa e vlerësimit të lëndës / udhëzimeve].

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe koordinatori i Sigurimit të cilësisë, në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit që mbulon programin e studimit, janë përgjegjës për monitorimin dhe menaxhimin e problematikave të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies [RVB, fq. 70].

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Procedurat e Sigurimit të cilësisë rishikohen, raportet e cilësisë me rekomandimet përkatëse i dorëzohen Komisionit të përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Senatit [RVB fq. 71].

### **Vlerësimi sipas Standardeve**



Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> </ol>	<p>Universiteti Epoka (PCQA/KPSC), nëpërmjet Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, përdor instrumente matëse dhe vlerësuese për metodologjitë vlerësuese që aplikon, siç janë: vlerësimet e studentëve, vlerësimet e kolegëve, forma individuale të vlerësimit të performancës së stafit akademik si dhe vlerësimin e raporteve vjetore mbi mësimdhënien, të nxënit dhe standardet përkatëse të cilësisë të hartuara nga Departamenti në fund të vitit akademik.</p> <p>U Epoka e kryen vlerësimin duke përdorur instrumente të tërthorta dhe të drejtpërdrejta me student të diplomuar, ish studentë, staf akademik dhe administrativ. Vlerësimet e studentëve përpunohen në rrugë elektronike dhe konkluzionet ashtu si dhe konkluzionet e komentet bëhen publike me përfundimin e lëndës. Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani janë të informuar në detaje në lidhje me rezultatet e procesit dhe kanë mundësi të ndërhyjnë për të bërë përmirësime kur është e nevojshme.</p> <p>Raporti vjetor institucional miratohet nga Senati dhe bëhet publik për të gjithë të interesuarit.</p>
<b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Programi i studimit MP “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është i disponueshëm në faqen institucionale (<a href="http://aeqi.epoka.edu.al/">http://aeqi.epoka.edu.al/</a>)</p> <p>U Epoka publikon rregullisht manuale dhe broshura për vlerësimin e brendshëm, të cilat janë të disponueshme për studentët në ambientet e Universitetit Epoka; gjatë vizitës së vlerësimit të tilla gjendeshin në hollin e pritjes.</p> <p>Plani mësimor publikohet në faqen e internetit të U Epoka <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/">http://aeqi.epoka.edu.al/</a></p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve përfshihen ë materialet promocionale të U Epoka, të deklaruar në Ministrinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe publikohen në faqen e internetit të Universitetit Epoka. <a href="http://ce.epoka.edu.al/home-strategic-plan-2017-2022-">http://ce.epoka.edu.al/home-strategic-plan-2017-2022-</a></p>



**Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Universiteti "EPOKA" kryen një takim vjetor për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit; dhe përmban të dhëna mbi aspektet akademike, mbi performancën e studentëve, si p.sh. të dhëna të mësimdhënies dhe kalueshmëria e studentëve. Këto raporte janë pjesë e raporteve vjetore të aktivitetit, të përgatitura nga Universiteti dhe nga Departamentet përkatëse. Raportet përgjegjëse përmbajnë edhe anketat e studentëve dhe raportet e brendshme të vlerësimit. PCQA / KPSC, nëpërmjet komiteteve të tij, vlerëson periodikisht eficientësinë e mësimdhënies në Universitet, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve administrative.

**Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Universiteti Epoka është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditim të programit të studimit. Ri-akreditimi institucional më i fundit i Universitetit "EPOKA" është kryer në 2017 nga ASCAL.

UEpoka përdor të gjitha instrumentet për forcuar Sigurimin e Cilësisë, si Manuali i Sigurimit të cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit, Komisioni i Etikës etj, ku palët e interesuara si përfaqësuesit e studentëve, stafit akademik, dhe administrative janë pjesë e vlerësimit dhe mbikëqyrjes.

U Epoka në bazë të politikës së tij të përgjithshme për të siguruar cilësinë e programit të studimit, në përputhje me standardet e kërkuara nga Legjislacioni Shqiptar ka statutin, planin strategjik dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë.

Mekanizmat formal për rishikimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, janë rishikimi i planit mësimor para fillimit të çdo semestri dhe rishikimi periodik, të cilat miratohen nga Senati UEpoka me vendimmarrje kolegjiale

Pjesëmarrja e studentëve në nivele të vendimmarrjes është e detyrueshme. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senat, Këshillat e Fakulteteve dhe Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së institucionit. Kjo realizohet nëpërmjet Këshillit Studentor, i cili përfaqëson interesat e studentëve ë U Epoka dhe zgjidhet çdo vit nga votat e studentëve [Shtojca Plani Strategjik i UEpoka, 2018-2022], [Manuali i Sigurimit të cilësisë 2018]. UEpoka, kryen vlerësime të vazhdueshme për të siguruar që program i studimit është funksional



**Konkluzionet e vlerësimit:**

- GVJ konstaton se Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë është institucionalizuar në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, i cili siguron dhe monitoron cilësinë në Universitetin Epoka.
- U Epoka, kryen vlerësime për mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, duke përdorur instrumente të ndryshme nëpërmjet vlerësimit të studentëve, studentëve diplomuar, studentëve që kanë kryer studimet, stafit akademik dhe aktivitetit administrativ.
- Programi i studimit MP në “Menaxhim Risku & Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është paraparë t’i nënshtrohet edhe një vlerësimi vjetor nga UEpoka nëpërmjet Bordit të Progresit të Diplomimit, pas përfundimit të studimeve. U Epoka paraqet raport vjetor dhe analizë në nivel institucional për ecurinë e programit të studimit të ciklit të dytë. Raportet bëhen publike në faqen e internetit të PCQA/KPSC për studentët dhe të interesuarit e tjerë.
- Zhvillimi i një sistemi cilësie me qasje aktive bazuar mbi parimin Plan – Do – Check – Act ku Departamenti luan rolin thelbësor do të bënte që përmirësimi i cilësisë të lidhet drejtpërdrejtë me specifikat e programit të studimit.

**POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE****7. Programi i studimit, organizimi i tij****Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj*

RVB i U Epoka për këtë program studimi ka përcaktuar qartë misionin e tij, i cili synon që të ofrojë tek studentët mundësinë për t’u thelluar dhe studiuar në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit qasje të reja akademike dhe profesionale siç janë menaxhimi i riskut dhe mbrojtja ndaj zjarrit e strukturave ndërtimore. Qëllimi kryesor i programit është të zhvillojë tek studentët konceptet dhe parimet kryesore në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe Mbrojtja ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit.

Referuar RVB, objektivat e këtij programi studimi mund të përmbliidhen sa vijon:

- Programi synon t’u sigurojë pjesëmarrësve mundësi për përmirësimin e formimit të tyre për tema të ndryshme, duke përfshirë: praktikat për vlerësimin e riskut, menaxhimin e lumenjve, inxhinieria e sigurisë ndaj zjarrit, çështjet kritike në inxhinieri strukturore të sigurisë së zjarrit dhe kuptimin e zjarreve përkatëse dhe sjelljeve strukturore.
- Programi synon të zhvillojë burime njerëzore të kualifikuara të cilët mund të avancojnë njohuritë në fushën e menaxhimit të riskut dhe mbrojtjes ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit dhe të eksplorojnë rrugë të reja të zhvillimit profesional,
- Trajnimin e studentëve me punë praktike të orientuara drejt licencimit profesional për ushtrimin e profesionit të tyre dhe karrierën e tyre të ardhshme në menaxhimin e riskut dhe mbrojtjen ndaj zjarrit të strukturave ndërtimore.

Programi ofron një përzierje unike të lëndëve të ndryshme në fatkeqësitë natyrore siç janë burimet hidrike dhe zjarri. Studentët do të fitojnë aftësi shtesë dhe do të eksplorojnë rrugë të reja të zhvillimit profesional nën



mbikëqyrjen e një grupi ndërdisiplinor të personelit akademik në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin “EPOKA”.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit “ Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, ofrohet për herë të parë në vitin akademik 2018-2019 nga Universiteti Epoka.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit MP në “MR & MZIN” është me një kohëzgjatje normale në një vit akademik. Studentëve u kërkohet të marrin në semestrin e parë 3 (tre) lëndë me detyrim dhe 1 (një) lëndë me zgjedhje, ndërsa në semestrin e dytë, 2 (dy) lëndë me detyrim, 1 (një) lëndë praktikë dhe 1 (një) lëndë me zgjedhje në fushën e menaxhimit të riskut dhe mbrojtjes ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit. Çdo semestër përfshin 30 ECTS.

Programi fillon në muajin Tetor të çdo viti dhe organizohet në këtë mënyrë: Semestri i parë, fillon në 15 Tetor deri në muajin Shkurt dhe semestri i dytë fillon në muajin Mars deri në muajin Qershor.

Organizimi i programit të studimit;

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor <sup>1</sup>.
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor,
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë studenti,
- 1 orë mësimore = 60’

*Burimi: [ Tabela Nr. 23 “Kurrikula e MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtja ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”]*

Mënyra e përcaktimit të 1 krediti (ECTS) për format e studimit [ RVB, fq. 83 ] :

▪ Leksionet	304 orë në auditor dhe	789.75 orë punë e pavarur e studentit
▪ Seminaret	64 orë në auditor dhe	123.5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Laboratorët	32 orë në auditor dhe	61.75 orë punë e pavarur e studentit
▪ Praktikën e lëndëve	16 orë në auditor dhe	46.5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Praktikë profesionale	32 orë në auditor dhe	93 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	21 orë në auditor dhe	42 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara.

Plani mësimor nuk ka pësuar asnjë ndryshim në krahasim me programin e licencuar. Ky program studimi nuk ka nxjerrë ende studentët e tij të parë dhe është aktivizuar si program për herë të parë në vitin akademik 2018-2019. Sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë [Tabela nr 8, Aneks].

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 9, Aneks)

<sup>1</sup> *Shënim:* Programi i studimit veç 30 jave mesimore ne auditor, zhvillon dhe 1 (nje) jave njohje dhe pune per gatitore me studentet 1 (nje) jave provime.



Nga të dhënat e paraqitura në planin mësimor, sa i takon stafit akademik të angazhuar në këtë program studim, vërejmë se ai përbëhet nga 9 (nëntë) personel akademik me kohë të plotë, prej të cilëve 2 (dy) pedagogë kanë titullin Prof.As.Dr, dhe 6 (gjashtë) pedagogë me gradë shkencore PhD/Doktor. Tre pedagogë nga stafi akademik janë pedagogë me kohë të plotë të ftuar nga Departamenti i Arkitekturës në Universitetin Epoka.

Gjatë vizitës nuk rezultoi ndonjë lëvizje e stafit akademik apo ndryshime të ngarkesës mësimore respektive.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabus-et e lëndëve të paraqitura në Dosjen e vetëvlerësimit kanë elementët e mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Nga sa më sipër, GVJ shpreh mendimin se elementët që përmbajnë syllabus-et janë të mjaftueshëm dhe krijojnë një panoramën të plotë të përmbajtjes dhe strukturës së lëndëve.

Analizë e cilësisë së syllabuseve.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të Dosjes së RVB të Universitetit Epoka, por edhe gjatë vizitës vlerësuese, takimeve me personelin drejtues, akademik dhe ndihmës, GVJ vëren se cilësia e hartimit dhe përmbajtjes së syllabuseve është e mirë, madje për dy lëndë programet janë të njëjta me ato të programit të studimit në MSc.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), 60 kredite në vit. [dokumenti i Programit]. Programi i hartuar nga institucioni është licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të</p>	<p>Programi i studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit, është hartuar për të vazhduar dhe zgjeruar njohuritë në lëndët e fituara në ciklin</p>



<p>mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>e parë të studimeve të Inxhinieri Ndërtimi.</p> <p>Programi i studimit MP në Menaxhim Risku dhe Mbrojtja ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit, ka edhe module që i orientojnë studentët drejt metodave të kërkimit shkencor. [Shtojca 35, Rregullore mbi MP në MR &amp; MZIN].</p>
--	---

**Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi është hartuar për t’i ofruar studentëve njohuri të avancuara në fushat përkatëse të menaxhimit të riskut dhe mbrojtjen ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit, të cilat synojnë të zgjerojnë njohuritë mbi ato të nivelit bazë të fituara në ciklin e parë. [ Rregullore e Studimeve të ciklit të dytë ], [ Objektivat e kurrikulës së programit të studimit ].</p> <p>Metodat e vlerësimit janë të shprehura në syllabusin e secilës lëndë, ndërsa pedagogëve iu është lënë mundësia të organizojnë vlerësimin në përqindje të testeve të kontrollit Kriteret e vlerësimit janë: provimi i semestrit të parë, testet, projektet, prezantimet, frekuentimi i mësimin dhe provimi përfundimtar.</p> <p>[ Shtojca 43, Formulari i vlerësimit të provimit ], [ Shtojca 44, Forma e vlerësimit të periudhës së provimeve ], [ Tabela 29, Forma e kontrollit të njohurive ].</p>
--	---

**Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disa vjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit në Universitetin Epoka, është një program i hapur në kuadrin e projektin ERASMUS+ 2016 “ Njohuri për një shoqëri të qëndrueshme ” (K-Force), në të cilin janë përfshirë edhe vende si Serbia e Maqedonia e Veriut (lider) por edhe Mali i Zi, Bosnja Hercegovina Partnere të programit janë Danimarka (Universiteti Teknik), Suedia (Universiteti i Lundit) dhe Sllovakia ( Universiteti i Zilines ).</p> <p>Programi i studimit MP në “Menaxhim Risku dhe mbrojtje</p>
--	--



	<p>ndaj zjarrit në inxhinierinë e ndërtimit”, ofrohet në gjuhën angleze, duke e bërë këtë program konkurrues edhe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si nga teknike; aplikim e krediteve evropiane dhe kredite SHBA ashtu si edhe të metodave të vlerësimit.</p>
<p><b>Standardi I.6 – Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është hartuar në përputhje me profilin e Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Epoka dhe strategjinë e tij të zhvillimit. Programi i studimit ka paraparë dhe përgatitjen e një projekti përfundimtar në mënyrë të pavarur.</p> <p>Puna kërkimore e stafit akademik i angazhuar në programin master profesional, nëpërmjet botimeve të kërkimeve shkencore, kontribuon për realizimin e programit dhe është në përputhje me synimet dhe qëllimet e tij.</p> <p>[Takimi me stafin akademik],</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Diploma në programin e studimit “Master Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”, është përshtatur me nevojat e tregut të punës synon të përmbushë nevojat e sektorëve aktualë të tregut të brendshëm. Mungesa e specialistëve në menaxhimin e riskut apo mbrojtje ndaj zjarrit është një problematikë madhore që prek jo vetëm fushën e ndërtimit, por edhe mbrojtjen e territorit, ekonominë (sidomos atë bujqësore), shëndetin publik, mjedisin dhe ekosistemet. Prania e këtyre specialistëve do të mundësonte trajtimin e riskut duke parandaluar fenomene të kontrollueshme. Kjo do të kontribuonte në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, mjedisor dhe social.</p>
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Universiteti Epoka, ka kryer një studim për nevojat e tregut të punës; anketimet e kryera për këtë qëllim janë përdorur si bazë për hartimin e këtij programi studimi.</p> <p>Nga takimi me studentët u sugjerua që Universiteti Epoka duhet të llojë më shumë pranë Institucioneve shtetërore për objektivat dhe përmbajtjen e këtij programi, pasi ka mungesë informacioni për organizimin e këtij programi studimi, si një mundësi edhe për punësimin e kandidatëve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>[Shtojca 2: Studimi i tregut për hapjen e “Master Profesional” në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”].</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Sipas Statutit të Universitetit Epoka, institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me asnjë nga interesat kombëtare.</p> <p>Qëllimi i programit të studimit në MP në “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” është në përputhje me interesin kombëtar.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimit realizohet në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Ngarkesa akademike rezulton 60 ECTS dhe kohëzgjatja është 1 vit.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Pjesa më e madhe e informacionit është i aksesueshem online apo përmes portalit studentor. Në departament apo në strukturat e tjera të universitetit mund të merret informacion suplementar sipas kërkesës.</p> <p>Studentët informohen kryesisht online dhe përmes informacionit në hard copy që shpërndahet në fillim të semestrit.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Përgatitja e tezës është një proces ku pjesa më e madhe e punës bëhet individualisht nga studenti i cili udhëhiqet nga personeli akademik.</p> <p>Teza përgatitet në semestrin e fundit dhe konsiston në 187.5 orë pune (7.5 ECTS) që përfshijnë konsultime në auditor, punë të pavarur dhe praktikën profesionale.</p> <p>Rekomandohet ristrukturimi i tezës në planin mësimor duke diferencuar qartë aktivitetin e tezës nga praktika mësimore / profesionale.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>– Programi është i strukturuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe synon formimin profesional të ciklit të dytë. Përmbajtja e programit është në përputhje me objektivat formues të tij dhe strategjinë institucionale.</p>	



- Projekti K-Force (numër i projektit:573942-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP), synon te përmirësojë qëndrueshmërinë e rajonit nga rrezizet, është e nevojshme per te siguruar numurin e kerkuar te eksperteve, qe është per te modernizuar dhe zhvilluar arsimin e larte ne institucionet rajonale te arsimit te larte ne fushen e Menaxhimit te Rrezikut nga Fatkeqesite dhe Sigurine nga Zjarri, ne bashkepunim me universitete nga vendet e BE-se, qe kane zhvilluar programe studimi ne tri nivelet e studimit
- Studentët kanë informacion të mjaftueshëm mbi programin e studimit.
- Numri i orëve në auditor rezulton të jetë i ulët, ndërsa rezulton praktika profesionale e shkrirë me tezën përfundimtare të diplomës

Rekomandim:

- Rekomandohet ristrukturimi i tezës në planin mësimor duke diferencuar qartë aktivitetin e tezës nga praktika mësimore / profesionale, duke respektuar kategoritë e përcaktuara në VKM 41/2018.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.*

Organizimi i aktivitetit mësimor ka disa paqartësi në strukturim që lidhen kryesisht me sistemin e krediteve. Diferenca mes leksioneve dhe aktiviteteve të tjera (seminare / ushtrime) nuk është e përcaktuar qartë, duke mundësuar fleksibilitet për personelin akademik që të interpretojë orët në auditor si leksione klasike, diskutime ndërvepruese, ushtrime, punë praktike etj. Nuk ka një interpretim konstant të mënyrës sesi zërthehet 1 ECTS për çdo aktivitet mësimor. Për shembull, 1 ECTS leksione interpretohet here si 8.5 orë në auditor, dhe here si 6.4 orë. Një faktor konstant do të ndihmonte në strukturimin më të qartë të kurrikulës dhe të organizimit të aktivitetit mësimor.

Problemi kryesor që konstatohet në planin mësimor, është numri i ulët i orëve në auditor të parashikuara. Raporti i orëve në auditor me orët totale të programit të studimit është 432 /1500 ose mesatarisht 7.2 orë në auditor për çdo ECTS.

Masa e detyruar e frekuentimit është 60 % (ose 259 orë/1500). Duke marrë në konsideratë edhe numrin e ulët të orëve në auditor, rekomandohet që detyrimi i frekuentimit të rishikohet për të garantuar pjesëmarrjen e studentit.

Gjithashtu, shihet e nevojshme shkëputja e praktikës profesionale nga punimi i diplomës pasi këto dy aktivitete përputhen me dy kategori të ndryshme (C dhe D) sipas VKM 41/2018.

Mënyrat e mësimdhënies janë të ndryshme dhe zhvillohen kryesisht në auditor dhe laboratorë. Përgjithësisht, format e zgjedhura të mësimdhënies janë në përputhje me objektivat formuese të programit të studimit dhe me përmbajtjen e kurrikulës. Gjithashtu, përdorimi i infrastrukturës dhe pajisjeve në ndihmë të procesit mësimor, përputhen me programin e studimit në fjalë.

Duke u bazuar në natyrën specifike të programit të studimit, roli i departamentit në kontrollin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë duhet të jetë më aktiv. Departamenti mund të propozojë forma efikase të lidhura me fushën përkatëse për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione (43.75 ECTS)

304 orë në auditor, 789.75 orë punë e pavarur



- Seminare (7.5 ECTS) 64 orë në auditor, 123.5 orë punë e pavarur
- Laboratore (3.75 ECTS) 32 orë në auditor, 61.75 orë punë e pavarur
- Praktikë profesionale (5 ECTS) 32 orë në auditor, 93 orë punë e pavarur

Orët në auditor janë 432 / 1500 ndërkohë që raporti mes seminareve dhe leksioneve është 1 / 4.75.

Duke marrë në konsideratë që sistemi që aplikon universiteti konsiston në leksione ku përfshihen edhe forma të tjera të mësimdhënies (diskutime, workshope etj.) rekomandohet që këto aktivitete të shprehen më vete në planin mësimor.

**Format e kontrollit të njohurive**

Kontrulli i njohurive bëhet përmes komponentëve që vlerësojnë performancën në vazhdimësi gjatë semestrit.

Sipas lëndës, provimi përfundimtar ka një peshë që varion 30-60% e vlerësimit përfundimtar. Kjo mënyrë vlerësimi, konsiderohet efikase dhe ndihmon studentin që të ketë një ngarkesë të shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme gjatë semestrit.

**Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Sistemi i vlerësimit bazohet si në sistemin shqiptar të notave (1-10), ashtu edhe në atë amerikan të notave (0-4). Nota minimale kaluese është 5/10 e cila korrespondon me një totale të pikëve prej 60/100. Ky sistem konsiderohet si nxitës për studentin për të punuar dhe për të akumuluar pikët gjatë semestrit. Një mesatare (CGPA) minimale prej 1.8 / 4 është e nevojshme për t'u diplomuar dhe kjo korrespondon me notën 6.5/10.

Studentët me rezultate më të ulëta, duhet të përsërisin kurset ku kanë marrë vlerësime të ulëta, në mënyrë që të përfundojnë studimet. Gjithashtu, ky sistem siguron edhe rritjen e cilësisë së studentëve në diplomim.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.*

Zyra e regjistrimit të studentëve është përgjegjëse për informimin paraprak mbi programin e studimit dhe mbi ndjekjen e të gjitha procedurave të regjistrimit. Kualiteti i studentëve në hyrje është relativisht i mirë dhe mesatarja në hyrje është rreth 75/100 siç deklarohet në RVB.

Numri i studentëve për vitin akademik 2018-2019 është 20. Ky është viti i parë në të cilin zhvillohet ky program studimi. Ende nuk ka studentë të diplomuar, por nisur nga informacionet e marra në institucion, pritet që 20/20 studentë të përfundojnë studimet brenda vitit 2019.

Nga verifikimet dhe takimet e zhvilluara rezultojnë se të gjithë studentët janë paraprakisht të punësuar dhe vijnë nga eksperiencia të mëparshme profesionale. Kjo shkakton edhe vështirësi për shkak të ngarkesës së mbivendosur të programit të studimit me atë të punës. Rekomandohet që programi të ofrohet me kohë të zgjatur (1.5 vite) ose të ndiqet me shkëputje nga puna.

Gjithashtu, sot nuk ekziston një treg pune i mirëfilltë për specialistët e kësaj fushe, ndaj rekomandohet që institucioni të intensifikojë kontaktet dhe marrëdhëniet me të gjithë aktorët për të mundësuar pajisjen me licencë profesionale të specialistëve të formuar nga ky program.



Zyra e Alumni dhe e Karrierës është e mirëorganizuar dhe ndjek në vijimësi ecurinë e të diplomuarve, ndonëse për programin e studimit në fjalë nuk ka ende studentë të diplomuar.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat dhe kriteret për pranimin e studentëve rezultojnë në përputhje me legjislacionin mbi arsimin e lartë në Shqipëri.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Numri aktual i studentëve është 20. Mesatarja e studentëve në dalje nuk është e disponueshme pasi viti akademik nuk është përmbyllur ende. Duke qenë se ky është brezi i parë që diplomohet në këtë program studimi, mund të gjykojmë vetëm mbi notën mesatare në hyrje e cila është deklaruar të jetë 75/100

Nga Tabela 12 (ne Aneks) rezulton se 20 studentët e regjistruar në këtë program janë me një mesatare 75/100

- Të dhëna për punësimin e studentëve

Nuk ka të punësuar sipas programit të studimit. Ky është viti i parë i studimeve. Gjithsesi të gjithë studentët rezultojnë të punësuar paraprakisht për shkak të formimit të tyre të mëparshëm në Arkitekturë apo Inxhinieri.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Të gjithë studentët që ndjekin këtë Master Profesional kanë minimalisht një diploma studimi Bachelor me 180 ECTS. Një pjesë e tyre kanë kryer studime të integruara 5 vjeçare me 300 ECTS, ose edhe programe të tjera Master Shkencorë dhe / ose Profesionalë me 60 -120 ECTS.</p> <p>Studentët pranohen sipas kriterëve të vendosura nga institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga verifikimet e bëra në institucion (zyra e sekretarisë mësimore), rezulton se studentët janë pranuar në përputhje me kriteret e pranimit.</p> <p>Sistemi i mësimdhënies në Universitetin Epoka është në gjuhën angleze dhe studentët duhet të njohin këtë gjuhë në momentin e pranimit. Studenti paraqet dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar zotërimin e gjuhës së huaj në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit është i ri dhe nuk ka një trend mbi ecurinë e pranimeve dhe cilësinë e studentëve. Gjithësesi Fakulteti dhe Departamenti e kanë në rutinën e punës së tyre analizën mbi numrin e studentëve dhe kriteret e pranimit.</p>
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri I</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni, si dhe këshilltarët akademikë, ofrojnë suportin dhe informacionin e nevojshëm ndaj studentëve.</p>



<p>të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Megjithëse mundësitë e punësimit në përputhje me profilin sot janë të ulëta, figura e specialistit në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit mbetet shumë e rëndësishme dhe me perspektivë për të ardhmen.</p> <p>Aplikantët e rinj informohen përmes zyrës së pranimit dhe ueb-it të institucionit mbi përmbajtjen e programit.</p> <p>Informacioni mbi programin e studimit, vlefshmërinë, akreditimin etj. jepet kryesisht përmes ëëbit.</p> <p>Informim i mëtejshëm ofrohet pranë Fakultetit dhe Departamentit për të gjithë të interesuarit.</p>
---	--

**Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>NA</p> <p>Institucioni aplikon për akreditim për herë të parë.</p> <p>Të gjitha të dhënat që lidhen me këtë vit akademik disponohen nga institucioni.</p> <p>Universiteti menaxhon mjedise ne te cilat ka akses per informacione dhe burime per informacione ne menyre elektronike, apo baze te dhenash "online". Gjithashtu, perdorimi i software-ve per analiza dhe dizenjim te procesit te te nxenit apo Sekretaria e Fakultetit te Inxhinierise se Ndertimit dhe ajo e Universitetit, te cilat menaxhojne me sistem Digital te dhena te detajuara per studentet, stafin akademik, te dhenat per burimet njerezore etj.</p>
---	---

**Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni ka informacion të detajuar për studentët e diplomuar dhe mban të dhëna mbi avancimin e tyre në karrierë.</p> <p>Ky informacion është i detajuar dhe i përditësuar por jo relevant për studentët e këtij programi studimi, pasi 20 studentët e parë nuk janë diplomuar ende.</p>
--	--

**Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Informacioni për studentët aksesohet lehtësisht në faqen e internetit të institucionit si dhe përmes portalit të studentit. Informacion më i detajuar është i disponueshëm në Departament dhe Fakultet.</p> <p>Vihet re që edhe komunikimi mes studentëve dhe stafit akademik është i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm. Informacioni mbi vlerësimet është i disponueshëm.</p> <p>Nga takimet e zhvilluara vihet re se studentët rezultojnë mjaft të informuar mbi programin.</p>
---	---

**Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.**



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Personeli akademik ndihmon studentët gjatë aktivitetit të tyre duke i orientuar dhe duke adresuar problemet e tyre.</p> <p>Pritja e studentëve bëhet gjatë orareve të pritjes në zyrë.</p> <p>Duke pasur parasysh numrin e vogël të studentëve, sistemi i këshillimit rezulton mjaft efikas dhe kontaktet mes studentëve dhe autoriteteve apo personelit akademik, janë të thjeshta dhe frekvente.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni, orientojnë studentët gjatë studimeve të tyre dhe mbajnë kontaktet edhe pas diplomimit.</p> <p>Në fakt, studentët e kryejnë praktikën profesionale kryesisht në vendet e tyre të punës, ku jo gjithmonë garantohej një praktikë e vlefshme për programin e studimit. Aplikimi i marrëveshjeve institucionale dhe përfshirja e zyrës së Karrierës në koordinimin e praktikave do të mundësonte një zhvillim më efikas dhe të kontrolluar të praktikave.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në Masterin Profesional “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit” Studentët pranohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</li> <li>- Numri dhe cilësia e studentëve në vitin e parë të programit rezulton e kënaqshme.</li> <li>- Sistemi i informimit të studentëve është lehtësisht i aksesueshëm dhe studentët rezultojnë të jenë të mirëinformuar rreth programit të studimit dhe çështjeve të tjera që lidhen me studimet e tyre.</li> <li>- Informacioni është i disponueshëm online, në departament, në zyrën e karrierës dhe në zyrën e regjistrimit.</li> </ul>	

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.*

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë zhvillon punë kërkimore të vazhdueshme, bazuar kryesisht mbi kontributin individual të personelit akademik. Publikimet për çdo vit akademik janë të disponueshme online. Gjithashtu universiteti mbështet edhe projekte kërkimore dhe nxit publikimin dhe pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare.

Aktualisht i vetmi angazhim për t'u përmendur është organizimi i konferencës ICAUD 2019 e cila do të zhvillohet në muajin Tetor. Ndërkohë, kërkimi i lidhur drejtpërdrejtë me fushat që mbulon programi i studimit mungon.

Kërkimi individual që zhvillohet nga personeli akademik korrespondon kryesisht me aktivitetin e tyre të mësimdhënies. Gjithsesi, për momentin nuk u evidentuan projekte kërkimore në nivel Departamenti apo Fakulteti të financuara nga Universiteti.




### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor ( <http://fae.epoka.edu.al/home-publications-647-1854.html>

Lista e projekteve dhe të dhënave mbi kërkimin tregojnë një punë të fokusuar mbi kërkimin shkencor por njëkohësisht vënë në evidencë mungesën e kërkimit në fusha që lidhen drejtpërdrejtë me programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Pjesa më e madhe e personelit akademik është përfshirë në kërkim individual. Megjithëse vihet re një përkujdesje në rritje ndaj kërkimit shkencor, nuk ka projekte kërkimore aktive të financuara.  Kërkimi që zhvillohet lidhet kryesisht me aspekte dhe fusha teorike dhe më pak me aplikimet dhe kontributin e drejtpërdrejtë në sektorët e prodhimit apo shërbimeve.
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Personeli akademik flet rrjedhshëm gjuhën angleze dhe një pjesë e tyre kanë studiuar jashtë vendit.  Gjuha në të cilën zhvillohet programi është anglishtja. Kjo është edhe një nga pikat e forta të këtij programi studimi.
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor; <b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit.	Ka evidenca të aktiviteteve të zhvilluara për trajnimin e personelit akademik, kryesisht mbi metodologjinë e mësimdhënies dhe çështje të tjera të lidhura me aktivitetin akademik. Gjithsesi nuk ka një agjendë të rregullt për këto aktivitete.  Institucioni mbështet dhe promovon kualifikimin e personelit akademik, kryesisht përmes mobiliteteve në institucione partnere të financuar përmes programeve EU si Erasmus +, ose përmes mbështetjes së pjesëmarrjes në konferenca shkencore.
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; <b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; <b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program	Fakulteti i Arkitekturës dhe inxhinierisë ka një listë online të artikujve dhe punës kërkimore e cila mund të aksesohet në <a href="http://fae.epoka.edu.al/home-publications-647-1854.html">http://fae.epoka.edu.al/home-publications-647-1854.html</a>  E gjithë puna kërkimore, dokumentohet edhe në zyrën e kërkimit dhe projekteve të universitetit.  Kjo zyrë është përgjegjëse edhe për të mbajtur rekorde të aktivitetit kërkimor dhe përfshirjes së personelit akademik në të.





**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Puna individuale kërkimore e anëtarëve të personelit akademik, është baza e aktivitetit kërkimor shkencor që zhvillohet në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Kjo punë kërkimore fokusohet kryesisht në çështje teorike të lidhura me fushat e ndërtimit dhe arkitekturës por jo drejtpërdrejtë me çështjet e riskut dhe mbrojtjes ndaj zjarrit.
- Universiteti duket i përkushtuar në trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik dhe në promovimin e vazhdueshëm të punës kërkimore. Në çdo rast, mbështetje më e madhe duhet për të organizuar kërkim të vazhdueshëm dhe projekte kërkimore të financuara, sidomos në fusha me interes për programin MP Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e ndërtimit”.
- Përdorimi i gjuhës angleze në institucion konsiderohet si një nga pikat më të forta për studentët dhe për personelin akademik.
- Megjithëse ka përpjekje të vazhdueshme, programi i studimit duhet të mbështetet nga aktiviteti kërkimor i strukturuar, i financuar nga universiteti apo burime të jashtme. Aktivitetet kërkimore si konferencat, seminarët apo forma të tjera për të ndarë apo promovuar rezultatet e punës kërkimore duhet të zhvillohen rregullisht.

**11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun****Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.*

Universiteti Epoka është në marrëdhënie aktive me partnerë të fushës akademike dhe me institucione joakademike në Shqipëri dhe jashtë vendit. Mobilitetet drejt institucioneve akademike janë bërë aktive sidomos në vitet e fundit, kryesisht përmes shkëmbimeve të përfituara nga marrëveshjet Erasmus +.

Marrëdhëniet e universitetit me komunitetin e biznesit dhe tregun e punës janë të fokusuara kryesisht në zhvillimin e praktikave mësimore. Megjithëse ambienti duket aktiv duke ofruar marrëdhënie dinamike me partnerë të ndryshëm, kërkimi i lidhur me biznesin dhe industrinë nuk është zhvilluar ende në universitet.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabelat 15 ne aneks)

Sipas të dhënave të paraqitura nga institucioni, janë aktive një sërë bashkëpunimesh me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë. Këto bashkëpunime përfshijnë mobilitetin e studentëve, personelit dhe njëkohësisht pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.

Në RVB është paraqitur një listë me 48 partnerë ku përfshihen institucione shtetërore, IAL, komuniteti i biznesit dhe ai profesional etj. 8 prej marrëveshjeve janë projekte aktuale Erasmus plus, ndërsa pjesa tjetër janë Memorandume Mirëkuptimi (MoU) të lidhura me institucionet partnere (40).



## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Megjithëse universiteti ka një listë të gjatë partnerësh, praktikat shpesh zhvillohen pranë kompanive ku vetë studentët punojnë dhe që shpeshherë nuk mund të dokumentohen. Këto kompani nuk kanë një marrëdhënie zyrtare me universitetin dhe jo gjithmonë garantojnë kryerjen e aktiviteteve profesionale të dobishme për programin e studimit.</p> <p>Rekomandohet strukturimi dhe zyrtarizimi i aktivitetit të praktikës si një aktivitet shumë i rëndësishëm në një Master Profesional.</p> <p>Përzgjedhja e partnerëve të praktikave sugjerohet të kryhet duke mundësuar aktivitete në shërbim të përbajtjes së programit dhe me fokus tek menaxhimi i rrisqeve apo mbrojtja nga zjarri. Praktikrat duhet të dokumentohen dhe të ndiqen nga një supervisor akademik që koordinon të gjithë aktivitetin në përputhje me planin mësimor dhe syllabusin.</p> <p>Gjithashtu rekomandohet ndarja e krediteve të praktikës nga ato të diplomës në planin mësimor.</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Departamenti është përgjegjës për të rishikuar programin në bazë të ecurisë dhe problematikave. Rekomandohet nxitja e një qasjeje jo hierarkike që të stimulojë pjesëmarrjen dhe debatin aktiv të personelit akademik në proceset e hartimit dhe ose rishikimit të programit.</p> <p>Në nivel universiteti, bashkëpunimi mes anëtarëve të personelit rezulton eficient dhe i mirëstrukturuar. Struktura hierarkike e institucionit është përcaktuar në statut dhe në rregulloret përkatëse.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti ka një numër të madh partnerësh në rang akademik dhe në sektorin publik e atë profesional, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Ky rrjet është një aset i fortë për të ndërtuar cilësinë e programit dhe për të ofruar mundësi për studentët për trajnim, praktika profesionale, kontakt direkt dhe mundësi punësimi. Edhe për personelin akademik kjo është një mundësi e mirë për të mbetur në kontakt me mjedise të tjera akademike dhe me tregun e punës.</p> <p>Mbetet për t’u përmirësuar organizimi i praktikave profesionale, ku studenti duhet të zhvillojë praktikën në mënyrë të monitoruar, në një kompani që ka marrëdhënie me universitetin, me një program të miratuar paraprakisht dhe me një dokumentim të punës së bërë.</p> <p>Nuk ka një analizë të mirëfilltë të benefiteve të programit specifik nga marrëveshjet e lidhura. Ky raport do të ndihmonte në përmirësimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve që shkojnë përtej mobiliteteve apo zhvillimit të praktikave.</p>



**Konkluzionet e vlerësimit:**

- Universiteti Epoka ka një rrjet të gjerë partnerësh. Gjithsesi, nga vizita në universitet u konstatua se për programin e studimit në fjalë, praktikat profesionale janë zhvilluar pjesërisht në kompani me të cilat universiteti nuk ka marrëveshje, pa mbikëqyrje akademike, pa dokumentim të punës së kryer dhe pa evidencë të qartë të përputhshmërisë së aktivitetit të praktikës me përmbajtjen e programit të studimit.

**Rekomandim**

- *Konsolidimi dhe strukturimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me partnerët do të sillte jo vetëm mbështetje për aktivitetin e kurrikulës, por njëkohësisht edhe marrëdhënie të vazhdueshme të ambientit akademik me tregun dhe përfshirje të akademikëve në kërkim të lidhur me industrinë.*





## ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT

### (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES - MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT).

#### **a. Pika të forta:**


- 1) Mësimdhënia në Universitetin Epoka zhvillohet në gjuhën angleze.
- 2) Infrastruktura dhe shërbimet në universitet ofrojnë një mjedis cilësor për aktivitetin akademik.
- 3) Mbështetja e programit të studimit në një projekt ndërkombëtar me kontribut dhe ekspertizë të universiteteve partnere.
- 4) Pranimet në vitin akademik 2018-2019 janë bërë pa tarifë studimi, gjë që nxit interes të lartë dhe përzgjedhje të studentëve më cilësorë.
- 5) Programi i studimit është i vetmi i këtij lloji në Shqipëri dhe ofron formim për specialistë në menaxhim risku dhe mbrojtje ndaj zjarrit, dy fusha mjaft të rëndësishme për zhvillimin e vendit dhe sigurinë e popullatës.
- 6) Personeli akademik mbulohet në masën 100% nga pedagogë me kohë të plotë të trajnuar në përputhje me nevojat e programit të studimit.

#### **b. Pika të dobëta:**

- 1) Në raport me kohëzgjatjen e programit të studimit, orët në auditor janë të pakta (432 / 1500).
- 2) Studentët janë kryesisht të punësuar me kohë të plotë dhe zhvillojnë aktivitetin mësimor në orët e pasdites. Kjo sjell mbingarkesë, vështirësi në frekuentim dhe mungesë hapësire kohore për të konsumuar plotësisht orët jashtë auditorit që parashikon plani mësimor.
- 3) Personeli akademik është i mbingarkuar me mësimdhënie. Ngarkesa e tyre mësimore konsumohet kryesisht në programe të tjera studimi.
- 4) Aktivitetet praktike brenda programit të studimit janë ende të pastrukturuara dhe jo plotësisht në shërbim të përmbajtjes së programit.
- 5) Aktiviteti kërkimor në lidhje me fushat që mbulon programi i studimit duhet të përmirësohet dhe intensifikohet.
- 6) Kontaktet me industrinë vendase apo me autoritet lokale janë të pakta dhe nuk kanë impakt në të ardhura apo në zhvillim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

#### **c. Mundësitë:**

- 1) Përmirësimi i Sistemit të Sigurimit të Cilësisë përmes krijimit të një sistemi të fokusuar në Departament / Fakultet dhe që lidhet drejtpërdrejtë me specifikat e programit të studimit mund të ndikojë më shumë në rritjen e cilësisë. Ky sistem duhet të ketë një qasje aktive bazuar mbi parimin Plan – Do – Check – Act ku roli i Departamentit është thelbësor.
- 2) Aktiviteti i programit të studimit mund të zhvillohet mjaft nëse bashkëpunohet me autoritete publike apo kompani vendase në organizimin e praktikave, seminareve, vizitave lidhur me fushat që trajton programi i studimit.





- 3) Lobimi i institucionit me të gjithë aktorët publikë e privatë për njohjen dhe vlerësimin e figurës së specialistit në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit si një figurë e domosdoshme për sigurinë e popullatës dhe të territorit.
- 4) Mobilitetet e personelit akademik apo edhe të studentëve ndikojnë ndjeshëm në aktivitetin akademik. Intensifikimi i këtyre shkëmbimeve shihet si një mundësi e mirë për përmirësimin e cilësisë dhe përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës.
- 5) Departamenti mund të bëjë përpjekje të mëtejshme për të përfituar fonde kërkimi (nga universiteti, industria, agjencitë shtetërore, fondet EU) në mënyrë që të krijojë një mjedis kërkimi të strukturuar dhe me impakt të lartë.
- 6) Universiteti mund të eksplorojë burime të tjera të ardhurash në mënyrë që të rrisë mbështetjen për kërkimin shkencor.

**d. Pengesat:**

- 1) Kërkesa e ulët aktuale e tregut për specialistë në Menaxhim Risku dhe në Mbrojtje ndaj Zjarrit.
- 2) Mungesa e legjislacionit që përcakton rolin dhe kompetencat e specialistëve në Menaxhim Risku dhe në Mbrojtje ndaj Zjarrit.

**Rekomandime:**

- 1) *Rekomandohet rishikimi i përmbajtjes dhe/ose emërimit të programit të studimit që të reflektohet përputhshmëri e plotë mes aktiviteteve formuese të ofruara dhe profilit të specialistit të formuar përmes këtyre aktiviteteve. Aktualisht programi jep njohuri formuese mbi fusha që lidhen me inxhinierinë e ndërtimit, arkitekturën, peizazhin, planifikimin / territorin, topografinë, gjeologjinë, hidrologjinë, mjedisin etj. GVJ sugjeron shkurtimin e emërimit të programit në Master Profesional “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit”, ose rishikimin e përmbajtjes së kurrikulës për t’u fokusuar vetëm në fushat që janë pjesë e inxhinierisë së ndërtimit.*
- 2) *Duke pasur parasysh se në vitin akademik 2018-2019 të gjithë studentët kanë qenë të punësuar me kohë të plotë, rekomandohet që programi i studimit të zhvillohet me kohë të zgjatur (1.5 vite). Në këtë mënyrë garantohet që studentët të mos kenë mbingarkesë gjatë zhvillimit të programit dhe aktivitetet e parashikuara në planin mësimor të kryhen plotësisht.*
- 3) *Rekomandohet rishikimi i planit mësimor dhe rregullores së programit të studimit me qëllim rritjen e orëve totale që studenti duhet të konsumojë në auditor.*
- 4) *Rekomandohet ndarja e praktikës mësimore / profesionale nga puna për temën e diplomës si dy aktivitete që i përkasin kategorive të ndryshme sipas VKM 41/2018.*
- 5) *Rekomandohet organizimi i praktikës profesionale nga institucioni në bashkëpunim me partnerë publikë apo privatë. Programi i praktikës duhet të miratohet nga departamenti dhe duhet të monitorohet nga personeli akademik. Gjithashtu puna praktike duhet të dokumentohet në trajtë relacioni ose ditari dhe të miratohet nga institucioni / kompania që e ofron praktikën.*



## SWOT ANALYSES

### **a) STRENGTHS**

- 1) Teaching at Epoka University is conducted in English.
- 2) The infrastructure and services at the university provide a qualitative environment for academic activity.
- 3) The support of the program in an international project with the contribution and expertise of partner universities.
- 4) Admissions in the 2018-2019 academic year had no tuition fee, which raises high interest and enables selection of qualitative students.
- 5) The offered program is the only one of its kind in Albania and provides training for specialists in risk management and fire protection, two very important areas for the development of the country and population safety.
- 6) Academic staff is covered 100% by full-time lecturers trained in accordance with the needs of the program.

### **b) WEAKNESSES**

- 1) The number of class hours is low if compared to the duration of the program (432/1500).
- 2) In general students are working full time and follow the studies in the afternoon. This results in overloading, difficulty in attendance and lack of time to fully consume the study hours foreseen by the syllabus.
- 3) The academic staffs are overloaded with teaching activity. Their teaching load is mainly consumed in other programs.
- 4) Practical activities within the program are still unstructured and not fully serving the program content.
- 5) Research activity in the areas covered by the program should be improved and intensified.
- 6) Contact with local industry or local authorities are low and have no impact on revenue or development of teaching and research.

### **c) OPPORTUNITIES**

- 1) Improving the Quality Assurance System through the creation of a Department / Faculty focused system that is directly related to the specifics of the study program can further enhance quality. This system should have an active approach based on the Plan - Do - Check - Act principle where the role of the Department is essential.
- 2) The program's activity can be further developed if collaborating with public authorities or local companies in organizing internships, seminars, visits related to the areas covered by the program.
- 3) Lobbying of the institution with all public and private actors for the recognition of the role of the specialist in Risk Management and Fire Protection as an indispensable figure for population and territory safety.
- 4) The mobility of academic staff or even students significantly affects academic activity. Intensifying these exchanges is seen as a good opportunity for quality improvement and continuous updating of the curriculum.
- 5) The Department may make further efforts to obtain research funding (from university, industry, government agencies, EU funds) in order to create a structured and high impact research environment.



- 6) The university may explore other sources of income in order to increase the support for research.

#### d) THREATS

- 1) Low current market demand for specialists in Risk Management and Fire Protection.
- 2) Lack of legislation defining the role and competence of specialists in Risk Management and Fire Protection.

#### RECOMMENDATIONS:

- 1) *It is recommended to revise the content and / or title of the study program to reflect full compliance between the training activities offered and the profile of the specialist formed through these activities. Currently the program provides formative knowledge on areas related to civil engineering, architecture, landscape, planning / territory, topography, geology, hydrology, environment, etc. The EEG suggests shortening the program title to **Professional Master in "Risk Management and Fire Protection"**, or revising the curriculum content to focus only on areas that are part of civil engineering.*
- 2) *Given that in the 2018-2019 academic year all students were full-time employed, it is recommended that the study program be developed on a long-term basis (1.5 years). This ensures that students are not overloaded during program development and that the activities foreseen in the syllabus are fully completed.*
- 3) *It is recommended to revise the syllabus and regulation of the study program in order to increase the total hours that the student should consume in the auditorium.*
- 4) *It is recommended to separate teaching / professional practice from the diploma thesis as two activities belonging to different categories according to DCM 41/2018.*
- 5) *It is recommended that the institution organizes professional practice in cooperation with public or private partners. The internship program must be approved by the department and monitored by academic staff. Also the internship should be documented in the form of "report" or "diary" and approved by the institution / company providing the internship.*

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof. As. Fisnik Kadiu

Dr. Gjergji Islami